



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

290, 297/20

Data/Datum: 26.06.2020

PRISHTINE

PSH.nr.290/20  
297/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “PBC Sh.P.K-Prishtinë si dhe ankesës së OE “DTP” Pro-Computers”-Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “NAS Systems Sh.p.k”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit”, me nr. të prok: 651-19-7027-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjilan, më datën: 25.06.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “PBC Sh.P.K-Prishtinë dhe OE “DTP” Pro-Computers”-Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit”, me nr. të prok: 651-19-7027-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjilan.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit”, me nr. të prok: 651-19-7027-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjilan dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “PBC Sh.P.K-Prishtinë dhe OE “DTP” Pro-Computers”-Gjilan, aprovohen pjesërisht si të bazuara, ankuesve i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “PBC Sh.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 12.05.2020 me nr. 290/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit”, me nr. të prok: 651-19-7027-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjilan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 28, 59 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues OE “DTP” Pro-Computers”-Gjilan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 13.05.2020 me nr. 297/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit”, me nr. të prok: 651-19-7027-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjilan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 52, 56.3, 59, 72 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese dhe eksperti teknik i prokurimit në raportin e dt: 29.05.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit Paneli Shqyrtues i OSHP-së ka nxjerrë 3 vendime,

numër 688/19, 828/19, 112/20. Sqarimet e pretendimeve të ankesës 290/20, të OE “PBC”

#### Përgjigje në pretendimin ankimor – 1

OE ankues pretendon se nuk qëndron arsyetimi i eliminimit të OE ankues lidhur me mosdorëzim nga OE të katalogut apo broshurës me specifikimet teknike për pozicionin 3. AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka specifikuar kërkesën numër 3-OE duhet të dorëzoj katalogë apo broshura për produktet e ofertuara, si dhe dëshminë e kërkuar dokumentare për përmbushjen e kërkesës 3.Katalogu ose broshura. Më tej në Aneksin1, Specifikimet teknike të detyrueshme, në pozicionin 3, AK ka kërkuar “Sensor për matjen e gjatësisë” me specifikimin teknik “Sensorforheightmeasurementof the enteringvehicle, installed in 5m console pole”. Në tenderin e dorëzuar nga OE ankues, në skedarin “Pjesa 3”, në faqën me numrin rendor 24 ( shënjuar me në këndin sipër me numër 109 ) paraqitet broshura me specifikimin teknik për Sensor për matjen e gjatësisë. Këtu përshkruhet produkti i Spark SMGJ 5m, me specifikacionin e ofruar të njëjtë sikurse është kërkuar dhe imazhin ilustrativ të produktit të ofertuar nga OE ankues. Rrjedhimisht sipas kërkesës së paraqitur në dosjen e tenderit, OE ankues ka paraqitur broshurë që përmban elementet e kërkuara nga AK, shtuar me imazhin ilustrativ dhe modelin e precizuar. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

#### Përgjigje në pretendimin ankimor - 2

OE ankues pretendon se nuk qëndron arsyetimi i eliminimit të OE ankues për Pozicionin 4. Lidhur me këtë pikë sipas Raporti të Vlerësimit të Tenderëve, AK, me datë 08.04.2020 ka precizuar se ka kërkuar sqarime shtesë nga OE PBC, ku ka pranuar dokumentin që përshkruhet modeli NBC212-2, dhe ku është specifikuar ...LED signalhead F210mm. Ndërsa AK ka kërkuar në ueb faqen e prodhuesit ku ka gjetur se ky specifikim për këtë model është F200mm. AK kishte vlerësuar si mospërputhje të specifikimeve teknike dhe rrjedhimisht e ka cilësuar si mospërmbushje të specifikimeve në këtë pikë. OE ankues se bashku me ankesën e ka dorëzuar dokumentin e dërguar nga prodhuesi, e të cilin e kishte prezantuar tek AK gjatë periudhës së sqarimeve. Po ashtu, OE ankues ka dorëzuar korrespondencën e postës elektronike me prodhuesin, ku në emailin e datës 24 prill 2020, përfaqësuesi i OE PBC ka konfirmim nga prodhuesi se produktin NBC212-2, është 210 mm. Në të njëjtën datë, përfaqësuesi i prodhuesit është përgjigjur në email duke konfirmuar dokumentin e dërguar nga prodhuesi, si vijon:... “Ne jemi prodhues dhe prodhojmë sipas kërkesës së klientit, përndryshe nuk do të kishim vulosur broshurën. Pra, ne me konfirmimin e porosisë nga klienti do të prodhojmë të njëjtin model me dimensionet e kërkuara nga klientët tanë.”. Eksperti teknik me datë 20.05.2020 përmes emailit ka kërkuar nga prodhuesi informacion shtesë në lidhje me këtë pikë të pretendimit, ku po ashtu është bashkangjitur dokumenti i prezantuar nga OE ankues, ku specifikohet dimensionin 210mm. Me datë 21.05.2020, prodhuesi ka dërguar email ku ka

sqaruar se dimensionet e dritës me panel janë 210mm, ndërsa vetëm të dritës janë 190mm. Andaj, marrë për bazë specifikimin e kërkesës nga AK në dosjen e tenderit, për pozicionin 4 -“Trafficlights pole (galvanized) with LED signalhead F210mm x 2 (greenandred)” dhe sqarimin e dhënë nga prodhuesi në lidhje me dimensionet, është e qartë se përmbushet kërkesa dhe pretendimi ankimor është i bazuar.

#### Përgjigje në pretendimin ankimor –3

OE ankues pretendon se nuk qëndron arsyetimi i eliminimit të specifikuar nga AK, në lidhje me kërkesën numër 7 të Dosjes së Tenderit, ku në Raportin e Vlerësimit të Tenderëve, të datës 22.04.2020, AK ka specifikuar se OE PBC është zhvillues i aplikacionit softuerik por jo edhe prodhues i terminaleve dhe monitorëve. AK, në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën numër 7 “OE duhet të ketë Autorizim nga prodhuesi për Terminalet dhe monitorët.” Si dëshmi dokumentarë për përmbushjen e kërkesës ka kërkuar Kopjen e autorizimit. Në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është prezantuar Autorizimi ( dekaratë për autorizim) të lëshuar nga vet PBC, ku deklarohet se kompania është vetë prodhuese e zgjidhjes për terminale. Po ashtu OE ankues ka dorëzuar edhe referenca përmes të cilave evidentohet se OE ankues ka implementuar projekte në disa institucione sikurse janë Komuna e Podujevës, Universiteti i Prishtinës dhe Spitali i Përgjithshëm në Gjilan. Dhe të njëjtat i ka dërguar me datë 13.04.2020 tek AK, pas kërkesës për sqarime shtesë. Megjithatë në mes të referencave të lëshuara nga institucionet dhe autorizimit të lëshuar nga vetë kompania, në njërën anë dhe kërkimeve në ueb faqen e OE ankues në anën tjetër, AK vlerësimin, rrjedhimisht konstatimin e ka bazuar në faktin se nuk mund të gjendet informacion në ueb që do të argumentonte faktin se OE ankues është prodhues i këtyre produkteve. AK bazuar në referencat e prezantuara ka mundur të sqarojë këtë dilemë dhe informacionet e siguruara nga implementimi i projekteve të tilla në institucione tjera do të ishin më bindëse se të dhënat në ueb faqen e OE ankues. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

#### Përgjigje në pretendimin ankimor – 4

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi qënë ofertën e tyre kanë katalog/broshure e as specifikim për Serverin Qendror të Sistemit e as për Terminal të Pagesave dhe se Elektrosoft, fare nuk prodhon RackServer, Monitor, Switch, Routerfor VPN, IP Intercom, PC, BarcodeReader, SamrtcardReader, Printer. AK në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka kërkuar që OE duhet te dorëzojkatalogje apo broshura për produktet e ofertuara dhe për këtë kërkesë të ofrojnë dëshmi - katalogun ose broshura. OE i rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar dokumentin katalogu ku janë paraqitur pajisjet e kërkuara në dosjen e tenderit. Në faqen 18, janë paraqitur disa specifikime dhe imazhi për Serverin qendror të sistemit. Specifikimet janë identike të

përshkruara sikurse në dosjen e tenderit. Megjithatë në imazhin e paraqitur, ka mospërputhje me specifikimin teknik. Në specifikime të përshkruara në këtë dokument dhe ato të kërkuara në dosjen e tenderit është .. “System Server, 4U 19“ RackMountingHousingWith monitor 21”, përderisa nuk ka ndonjë model apo shënim që lidhet me serverin. Në lidhje me switch nuk përputhet po ashtu specifikimet teknike të precizuara me modelin TP Link që shihet në foto, përderisa është shënuar që ofertohej me Switch 8 portesh, në imazh është paraqitur switch TP Link16 portesh. Po ashtu numri/shifra e precizuar ESNET 8 nuk korrespondon me ndonjë model të pajisjeve të prodhuesit TP LINK. Është e qartë se ky dokument nuk mund të pretendohet së është broshurë apo katalog për pajisjet e specifikuar përbrenda pozicionit 5. Serveri qendror të sistemit, pasi që përveç rackcabinetit nuk korrespondojnë specifiket o ofertuara me pajisjet në imazh, më tej numrat apo shifrat e specifikuar si modele nuk korrespondojnë me modele serike apo specifike të prodhuesve të pajisjeve sikurse ato të kërkuara. Në fund nuk mund të pretendohet se Elektrosoft është prodhues i pajisjeve të TI-së sikurse janë Rack Server, Monitor, Switch, Routerfor VPN, PC, BarcodeReader, Printer, pasi që kjo precizohet qartë në autorizim e prodhuesit Elektrosoft, të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë ku theksohet se Elektrosoft është prodhues i Sistemit për Menaxhimin e Parkingut që konsiston në Terminale hyrëse dhe dalëse dhe pajisjet përcjellëse. Pra fushëveprimi i veprimtarisë së prodhuesit nuk përfshinë pajisje të TI-së sikurse janë Rack Server, Monitor, Switch, Routerfor VPN, PC, BarcodeReader, Printer, Monitor 20” touchscreen, UPS. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i qëndrueshëm pasi që duke mos paraqitur katalog apo broshurë të këtyre pajisjeve, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën 3, tek kapaciteti teknik dhe profesional.

#### Përgjigje në pretendimin ankimor – 5

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk përmbush specifikimet teknike për LED display për persona dhe monitorë te jene twosided (dy anesh- dy panelesh) dhe 32x32. Në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është prezantuar broshura e prodhuesit SparkfunElectronic, përkatësisht produktin RGB LED Matrix Panel - 32x64. Në një kërkim tek faqja zyrtare e prodhuesit mund të shihet qartë se produkti është 1 side panel dhe jo sikurse është kërkuar në specifikimin e precizuar nga AK në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Në vegzën<https://www.sparkfun.com/products/14718> është paraqitur produkti ku në imazhet dhe videon e produktit shihet qartë që paneli është një anësorë apo 1 side sikurse në imazhin e mëposhtëm të marrë në këtë vegzë.




Figura 1. Pjesa e pasme e panelit RGB LED Matrix Panel - 32x64

#### Përgjigje në pretendimin ankimor – 6

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar asnjë kontratë të realizuar për punë të përafërta - në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

AK në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka kërkuar që OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 2 kontrata të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Për këtë kërkesë AK ka kërkuar si dëshmi një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e kontratave ku janë evidentuar 5 kontrata të realizuara. Poashtu janë dorëzuar referencat për këto kontrata. Duke qenë që sipas kërkesës së specifikuar, konsiderojmë se është plotësuar kërkesa, pasi që janë prezantuar së paku 2 kontrata të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit. Andaj pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm.

---

#### Sqarimet e pretendimeve të ankesës 297/20, të OE “Pro Computers”

Fillimisht sqarojmë se disa nga pretendimet ankimor të paraqitur në këtë ankesë janë trajtuar përmes raportit paraprak të dorëzuar nga eksperti shqyrtues/teknik me datë 24.02.2020, rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjykuar dhe ka vendosur në vendimin numër 112/20 të datës 11.03.2020.

Andaj, eksperti shqyrtues dhe teknik konsiderojnë se ri-shqyrtimi i pretendimit të njëjtë ankimor është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së OSHP-së 01/2017, përkatësisht nenin 16, paragrafi 2, dhe në të njëjtën kohë e njofton panelin shqyrtues se pretendimet ankimore janë trajtuar, rrjedhimisht qëndrojmë pranë sqarimit të dhënë në raportin paraprak të datës 24.02.2020.

Ndërsa lidhur me pretendimet e përgjithësuara për mosplotësim të kërkesave teknike dhe profesionale të OE të rekomanduar për kontratë, qëndrojnë sqarimet e dhëna në përgjigjet 4 dhe 5 të këtij raporti.

Përgjigje në pretendimin ankimor -7

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikatën me fushëveprim joadekuat të ISO 9001 si dhe vë në pikëpyetje origjinalitetin e certifikatës, dhe afatin.

AK, në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën numër 8-“OE duhet të jete i certifikuar me ISO 9001” dhe si dëshmi dokumentare për përmbushjen e kërkesës është kërkuar certifikata duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali.

- a) Në tenderit e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është prezantuar certifikata ISO 9001, me numër ER-95-QMS. Certifikata ka përmbajtje në gjuhën shqipe dhe angleze dhe është lëshuar EAS International me seli në Shkup. Megjithatë nuk kemi mund të verifikojmë origjinalitetin e certifikatës pasi që në ueb faqe, nuk jepet një mundësi e tillë.
- b) Në lidhje me pretendimin për certifikatë jo-adekuate, e theksojmë se fushëveprimi i ISO 9001 është Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë dhe në kërkesat e dosjes së tenderit, AK nuk ka kërkuar që certifikata e ledhuar ISO 9001 për OE, të jetë specifik për digjitalizim.
- c) Sa i përket afatit, Certifikata mban datën e lëshimit 11.05.2017 dhe datë të mbarimit 11.05.2020. Në lidhje me afatin, certifikata ka afat pas njoftimit për kontrate, megjithatë aktiviteti për shkak të ankesave të përsëritura për të njëjtin aktivitet të prokurimit, certifikata në momentin e pretendimit ankimor nuk ka afat.

Andaj, sipas sqarimeve në pikat e mësipërme, pretendimi ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimin ankimor –7

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk përmbush specifikimet teknike për motor të rampës, konkretisht motori i ofertuar me fuqi 0,37 kw nuk mund të ngrisë rampën 4 m për 1.5 sekonda. Sipas broshurës së dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, specifikohet se motori i terminalit hyrës dhe dalës, ka mundësi të hapjes së barrierës apo rampës në gjatësi prej 4 metër, për 1.5 sekonda. Eksperti teknik ka bërë hulumtim për të vërtetuar pretendimin, dhe në bazë

të gjetjeve nuk mund të konstatohet se qëndron apo jo pretendimi për shkak se motor të ngjashëm kanë vlera të ndryshme të kohës së ngritjes së barrierës bazuar në parametra tjerë sikurse janë pesha dhe përbërësit e barrierës, pozicioni i vendosjes, etj. Megjithatë, AK ka mundur nga OE të kërkojë sqarime shtesë pas pretendimit të OE ankues, për të verifikuar nëse motori i kërkuar përmbush në mënyrë substanciale kërkesat e dosjes së tenderit. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues /teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "PBC" SH.P.K., Prishtinë dhe OE DPT "Pro Computers", Gjilan, të aprovohen si pjesërisht të bazuara, dhe propozohet që të anulohet vendimi i AK-së si dhe aktiviteti të kthehet në rivlerësim, konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 29.05.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP, lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo të njëjtit nuk kanë kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik "PBC Sh.P.K-Prishtinë, me datë: 01.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "DTP" Pro-Computers"-Gjilan, me datë: 29.05.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP, lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parshtruar kundër Njoftimit për dhënie të kontratës.



Paneli shqyrtues ne vijim jep konstatimet lidhur me ankesene OE "PBC" me numer te protokollit 290/20

Lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk qëndron arsyetimi i eliminimit të tijë lidhur me mosdorëzim nga ky OE katalogun apo broshurën me specifikimet teknike për pozicionin 3.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/ teknik konstaton se AK në dosjen e tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka specifikuar kërkesën numër 3-OE duhet te dorëzoj katalogë apo broshura për produktet e ofertuara, si dhe dëshminë e kërkuar dokumentare për përmbushjen e kërkesës 3.Katalogu ose broshura. Më tej në Aneksin1, Specifikimet teknike të detyrueshme, në pozicionin 3, AK ka kërkuar "Sensor për matjen e gjatësisë" me specifikimin teknik "Sensorforheightmeasurementof the enteringvehicle, installed in 5m console pole". Në tenderin e dorëzuar nga OE ankues, në skedarin "Pjesa 3", në faqën me numrin rendor 24 ( shënjuar me në këndin sipër me numër 109 ) paraqitet broshura me specifikimin teknik për Sensor për matjen e gjatësisë. Këtu përshkruhet produkti i Spark SMGJ 5m, me specifikacionin e ofruar të njëjtë sikurse është kërkuar dhe imazhin ilustrativ të produktit të ofertuar nga OE ankues. Rrjedhimisht sipas kërkesës së paraqitur në dosjen e tenderit, OE ankues ka paraqitur broshurë që përmban elementet e kërkuara nga AK, shtuar me imazhin ilustrativ dhe modelin e precizuar. Andaj vijim në perfundim se pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku pretendon se nuk qëndron arsyetimi i eliminimit të tije për Pozicionin 4.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues / teknik konstaton se lidhur me këtë pikë sipas Raporti të Vlerësimit të Tenderëve, AK, me datë 08.04.2020 ka precizuar se ka kërkuar sqarime shtesë nga OE PBC, ku ka pranuar dokumentin që përshkruhet modeli NBC212-2, dhe ku është specifikuar ...LED signalhead F210mm. Ndërsa AK ka kërkuar në ueb faqen e prodhuesit ku ka gjetur se ky specifikim për këtë model është F200mm. AK kishte vlerësuar si mospërputhje të specifikimeve teknike dhe rrjedhimisht e ka cilësuar si mospërmbushje të specifikimeve në këtë pikë. OE ankues se bashku me ankesën e ka dorëzuar dokumentin e dërguar nga prodhuesi, e të cilin e kishte prezantuar tek AK gjatë periudhës së sqarimeve. Po ashtu, OE ankues ka dorëzuar korrespondencën e postës elektronike me prodhuesin, ku në emailin e datës 24 prill 2020, përfaqësuesi i OE PBC ka konfirmim nga prodhuesi se produktin NBC212-2, është 210 mm. Në të njëjtën datë, përfaqësuesi i prodhuesit është përgjigjur në email duke konfirmuar dokumentin e dërguar nga prodhuesi, si vijon:... "Ne jemi prodhues dhe prodhojmë sipas kërkesës së klientit, përndryshe nuk do të kishim vulosur broshurën. Pra, ne me konfirmimin e porosisë nga klienti do të prodhojmë të njëjtin model me dimensionet e kërkuara nga klientët tanë.". Eksperti teknik me datë

20.05.2020 përmes emailit ka kërkuar nga prodhuesi informacion shtesë në lidhje me këtë pikë të pretendimit, ku po ashtu është bashkangjitur dokumenti i prezantuar nga OE ankues, ku specifikohet dimensionimi 210mm. Me datë 21.05.2020, prodhuesi ka dërguar email ku ka sqaruar se dimensionet e dritës me panel janë 210mm, ndërsa vetëm të dritës janë 190mm. Andaj, marrë për bazë specifikimin e kërkesës nga AK në dosjen e tenderit, për pozicionin 4 -“Trafficlights pole (galvanized) with LED signalhead F210mm x 2 (greenandred)” dhe sqarimin e dhënë nga prodhuesi në lidhje me dimensionet, është e qartë se OE në fjale përmbushet kërkesa dhe pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku pretendon se nuk qëndron arsyetimi i eliminimit të specifikuar nga AK, në lidhje me kërkesën numër 7 të Dosjes së Tenderit, ku në Raportin e Vlerësimit të Tenderëve, të datës 22.04.2020, AK ka specifikuar se OE PBC është zhvillues i aplikacionit softuerik por jo edhe prodhues i terminaleve dhe monitorëve.

Panelishqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik konstaton se AK, në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën numër 7 “OE duhet të ketë Autorizim nga prodhuesi për Terminalet dhe monitorët.” Si dëshmi dokumentarë për përmbushjen e kërkesës ka kërkuar Kopjen e autorizimit. Në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është prezantuar Autorizimi ( dekaratë për autorizim) të lëshuar nga vet PBC, ku deklarohet se kompania është vetë prodhuese e zgjidhjes për terminale. Po ashtu OE ankues ka dorëzuar edhe referenca përmes të cilave evidentohet se OE ankues ka implementuar projekte në disa institucione sikurse janë Komuna e Podujevës, Universiteti i Prishtinës dhe Spitali i Përgjithshëm në Gjilan. Dhe të njëjtat i ka dërguar me datë 13.04.2020 tek AK, pas kërkesës për sqarime shtesë. Megjithatë në mes të referencave të lëshuara nga institucionet dhe autorizimit të lëshuar nga vetë kompania, në njërin anë dhe kërkimeve në ueb faqen e OE ankues në anën tjetër, AK vlerësimin, rrjedhimisht konstatimin e ka bazuar në faktin se nuk mund të gjendet informacion në ueb që do të argumentonte faktin se OE ankues është prodhues i këtyre produkteve. AK bazuar në referencat e prezantuara ka mundur të sqarojë këtë dilemë dhe informacionet e siguruara nga implementimi i projekteve të tilla në institucione tjera do të ishin më bindëse se të dhënat në ueb faqen e OE ankues. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi qënë ofertën e tyre kanë katalog/broshure e as specifikim për Serverin Qendrore të Sistemit e as për Terminal të Pagesave dhe se Elektrosoft, fare nuk prodhon RackServer, Monitor, Switch, Routerfor VPN, IP Intercom, PC, BarcodeReader, SamrtcardReader, Printer.

Panelishqyrtues konform ekspertit shqyrtues / teknik sqaron se AK në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi

mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka kërkuar që OE duhet të dorëzojë katalogje apo broshura për produktet e ofertuara dhe për këtë kërkesë të ofrojnë dëshmi - katalogun ose broshura. OE i rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar dokumentin katalogu ku janë paraqitur pajisjet e kërkuara në dosjen e tenderit. Në faqen 18, janë paraqitur disa specifikime dhe imazhi për Serverin qendror të sistemit. Specifikimet janë identike të përshkruara sikurse në dosjen e tenderit. Megjithatë në imazhin e paraqitur, ka mospërputhje me specifikimin teknik. Në specifikime të përshkruara në këtë dokument dhe ato të kërkuara në dosjen e tenderit është .. “System Server, 4U 19“ RackMountingHousingWith monitor 21”, përderisa nuk ka ndonjë model apo shënim që lidhet me serverin. Në lidhje me switch nuk përputhet po ashtu specifikimet teknike të precizuara me modelin TP Link që shihet në foto, përderisa është shënuar që ofertohej me Switch 8 portesh, në imazh është paraqitur switch TP Link 16 portesh. Po ashtu numri/shifra e precizuar ESNET 8 nuk korrespondon me ndonjë model të pajisjeve të prodhuesit TP LINK. Është e qartë se ky dokument nuk mund të pretendohet se është broshurë apo katalog për pajisjet e specifikuara përbrenda pozicionit 5. Serveri qendror të sistemit, pasi që përveç rackcabinetit nuk korrespondojnë specifiket o ofertuara me pajisjet në imazh, më tej numrat apo shifrat e specifikuara si modele nuk korrespondojnë me modele serike apo specifike të prodhuesve të pajisjeve sikurse ato të kërkuara. Në fund nuk mund të pretendohet se Elektrosoft është prodhues i pajisjeve të TI-së sikurse janë Rack Server, Monitor, Switch, Routerfor VPN, PC, BarcodeReader, Printer, pasi që kjo precizohet qartë në autorizim e prodhuesit Elektrosoft, të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë ku theksohet se Elektrosoft është prodhues i Sistemit për Menaxhimin e Parkingut që konsiston në Terminale hyrëse dhe dalëse dhe pajisjet përcjellëse. Pra fushëveprimi i veprimtarisë së prodhuesit nuk përfshinë pajisje të TI-së sikurse janë Rack Server, Monitor, Switch, Routerfor VPN, PC, BarcodeReader, Printer, Monitor 20” touchscreen, UPS. Andaj panelishqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i qëndrueshëm pasi që duke mos paraqitur katalog apo broshurë të këtyre pajisjeve, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën 3, tek kapaciteti teknik dhe profesional.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk përmbush specifikimet teknike për LED display për persona dhe monitorë të jone twosided (dy anesh- dy panelesh) dhe 32x32.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/ teknik konstaton se në tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është prezantuar broshura e prodhuesit SparkfunElectronic, përkatësisht produktin RGB LED Matrix Panel - 32x64. Në një kërkim tek faqja zyrtare e prodhuesit mund të shihet qartë se produkti është 1 side panel dhe jo sikurse është kërkuar në specifikimin e precizuar nga AK në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Në vegzën <https://www.sparkfun.com/products/14718> është paraqitur

produkti ku në imazhet dhe videon e produktit shihet qartë që paneli është një anësorë apo 1 side sikurse në imazhin e mëposhtëm të marrë në këtë vegzë.




Figura 2. Pjesa e pasme e panelit RGB LED Matrix Panel - 32x64

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar asnjë kontratë të realizuar për punë të përafërta - në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/ teknik sqaron se AK në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka kërkuar që OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 2 kontrata të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Për këtë kërkesë AK ka kërkuar si dëshmi një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e kontratave ku janë evidentuar 5 kontrata të realizuara. Poashtu janë dorëzuar referencat për këto kontrata. Duke qenë që sipas kërkesës së specifikuar, konsiderojmë se është plotësuar kërkesa, pasi që janë prezantuar së paku 2 kontrata të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit. Andaj paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues /teknik konstaton se pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm.

Paneli shqyrtues në vijim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE "Pro Computers", për ankesën me numer të protokollit 297/20.

Paneli shqyrtues duke pasparasysh faktin se disa nga pretendimet ankimor të paraqitur në këtë ankesë janë trajtuar përmes raportit paraprak të dorëzuar nga eksperti shqyrtues/teknik me datë 24.02.2020, dhe për ato pretendime është vendosur me vendimin numër 112/20 të datës 11.03.2020, konstatojmë se ri-

shqyrtimi i pretendimit të njëjtë ankimor është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së OSHP-së 01/2017, përkatësisht nenin 16, paragrafi 2,

Po ashtu paneli mori parasysh faktin se eksperti shqyrtues / teknik në të njëjtën kohë e kan njofton panelin shqyrtues se pretendimet ankimore janë trajtuar nga ta dhe se ekspertet qëndrojnë pranë sqarimit të dhënë në raportin paraprak të datës 24.02.2020.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/ teknik sqaron se lidhur me pretendimet e përgjithësuara për mosplotësim të kërkesave teknike dhe profesionale të OE të rekomanduar për kontratë, qëndrojnë sqarimet e dhëna në konstatimet e dhëna si me lart .

Lidhur me pretendimit e OE ankues ku pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikatën me fushëveprim joadekuat të ISO 9001 si dhe vë në pikëpyetje origjinalitetin e certifikatës, dhe afatin.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues /teknik sqaron se AK, në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka specifikuar kërkesën numër 8-“OE duhet te jete i certifikuar me ISO 9001” dhe si dëshmi dokumentare për përmbushjen e kërkesës është kërkuar certifikata duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali.

- a) Në tenderit e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është prezantuar certifikata ISO 9001, me numër ER-95-QMS. Certifikata ka përmbajtje në gjuhën shqipe dhe angleze dhe është lëshuar EAS International me seli në Shkup. Megjithatë nuk kemi mund të verifikojmë origjinalitetin e certifikatës pasi që në ueb faqe, nuk jepet një mundësi e tillë.
- b) Në lidhje me pretendimin për certifikatë jo-adekuate, e theksojmë se fushëveprimi i ISO 9001 është Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë dhe në kërkesat e dosjes së tenderit, AK nuk ka kërkuar që certifikata e ledhuar ISO 9001 për OE, të jetë specifik për digjitalizim.
- c) Sa i përket afatit, Certifikata mban datën e lëshimit 11.05.2017 dhe datë të mbarimit 11.05.2020.Në lidhje me afatin, certifikata ka afat pas njoftimit për kontrate, megjithatë aktiviteti për shkak të ankesave të përsëritura për të njëjtin aktivitet të prokurimit, certifikata në momentin e pretendimit ankimor nuk ka afat.

Andaj,paneli shqyrtues konform sqarimeve te dhëna si me lart konstaton se , pretendimi ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ku pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk përmbush specifikimet teknike për motor të rampës, konkretisht motori i ofertuar me fuqi 0,37 kw nuk mund të ngrisë rampën 4 m për 1.5 sekonda.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se sipas broshurës së dorëzuar nga OE i

rekomanduar për kontratë, specifikohet se motori i terminalit hyrës dhe dalës, ka mundësi të hapjes së barrierës apo rampës në gjatësi prej 4 metër, për 1.5 sekonda. Eksperti teknik ka bërë hulumtim për të vërtetuar pretendimin, dhe në bazë të gjetjeve nuk mund të konstatohet se qëndron apo jo pretendimi për shkak se motor të ngjashëm kanë vlera të ndryshme të kohës së ngritjes së barrierës bazuar në parametra tjerë sikurse janë peshat dhe përbërësit e barrierës, pozicioni i vendosjes, etj. Megjithatë, me rastin e rivlersimit AK mund nga OE të kërkojë sqarime shtesë pas pretendimit të OE ankues, për të verifikuar nëse motori i kërkuar përmbush në mënyrë substanciale kërkesat e dosjes së tenderit. Andaj paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve për aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk është bërë konform nenit 7, 28 dhe 59 të LPP-së. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
**Nuhi PAÇARIZI**



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK-Komuna Gjilan
- 1x1 OE-"PBC Sh.P.K-Prishtinë
- 1x1 OE -"DTP" Pro-Computers"-Gjilan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.